

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv prezanton Raportin Vjetor të AMF-së në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, Kuvendi i Shqipërisë

Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, Janar – Prill 2022

Zhvillime të tjera

- 19 maj 2022 - AMF organizoi konferencën ndërkombëtare “Diversifikimi i sistemit financiar përmes reformave të tregut të kapitaleve”
- AMF nxjerr për konsultim publik një projekt rregullor të hartuar në zbatim të Ligjit nr. 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”

Publikime Profesionale

- **BIS** Diversiteti dhe gjithëpërfshirja – Përqafimi i ngjyrave të vërteta në mbikëqyrjen financiare
- **Global Risk Regulator**
 - Kërcënime të reja për stabilitetin financiar shfaqen me shpejtësi
 - Cili është hapi tjetër për rregullimin e kriptove?
 - FSB: A janë krypto-t një kërcënim për stabilitetin financiar global?

Informacione Ndërkombëtare

- Bosnje-Hercegovinë
- Mali i Zi
- Greqi
- Maqedonia e Veriut
- Kosovë
- Turqi

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv prezanton Raportin Vjetor të AMF-së për vitin 2021 në Komisionin për Ekonominë dhe Financat



10 maj - Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv prezanton Raportin Vjetor të AMF-së në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, Kuvendi i Shqipërisë

Viti 2021, edhe pse sfidues për ekonominë, si pasojë e presionit të ushtruar nga rikthimi i valës së pandemisë, shënoi një rimëkëmbje e rritje të shpejtë të tregjeve financiare nën mbikëqyrje.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Mete prezantoi më 10 maj 2022, në mbledhjen e Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat, raportin e veprimtarisë së Autoritetit për vitin 2021. Z. Mete bëri një pasqyrim të zhvillimeve kryesore gjatë vitit të kaluar, si edhe parashtroi disa nga objektivat kryesore të Autoritetit për periudhën në vazhdim.

Në fillim të fjalës së tij, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv theksoi se viti 2021, edhe pse sfidues për ekonominë si pasojë e presionit të ushtruar nga rikthimi i valës së pandemisë, shënoi një rimëkëmbje e rritje të shpejtë të tregjeve financiare nën mbikëqyrje. Qëndrueshmëria e tregjeve financiare nën mbikëqyrjen e Autoritetit, përfshi këtu edhe trajtimin e pagesave të tërmeteve, sugjeron se sektori ka kapacitetin të përballojë presionet e mundshme nga rreziqet e shtuara që paraqet situata aktuale – u shpreh z. Mete.

Më tej, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv u ndal tek ecuria e tregjeve nën mbikëqyrje për muajt e parë të vitit 2022, ku konstatohet se tregu i sigurimeve dhe ai i pensioneve private kanë vijuar rritjen, ndërsa asetet e tregut të fondeve të investimeve pësuan rënie me rreth 1% në tremujor, kryesisht si pasojë e luhatshmërisë në tregjet ndërkombëtare për shkak të konfliktit Rusi-Ukrainë. Edhe pse ekspozimi i fondeve tona të investimit ndaj këtyre tregjeve mbetet i kufizuar, situata po monitorohet në vijimësi nga Autoriteti, i cili ka miratuar edhe një udhëzim duke rekomanduar kujdes të shtuar nga shoqëritë administruese të fondeve dhe një sërë masash të tjera.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv prezanton Raportin Vjetor të AMF-së për vitin 2021 në Komisionin për Ekonominë dhe Financat

Vijon ...

Duke u ndalur te riformatimi i bazës ligjore e rregullatore, për të cilat Autoriteti mori vlerësime edhe në Raportin e fundit të Progresit të Komisionit Evropian, z. Mete nënvizoi se ligjet e reja kanë dhënë impakt në tregje. Ligji për sigurimin e detyrueshëm dhe rregulloret e miratuara nga Autoriteti në zbatim të tij sollën rritje të vlerës së dëmshpërblimit për disa kategori dëmsh, si edhe reduktim të afateve për trajtimin e dëmeve me vlerë deri në 100 mijë lekë. Janë adresuar problematikat lidhur me Fondin e Kompensimit, ku për herë të parë është krijuar një fond garancie, në vlerën prej 150 milionë lekë, për t'u përdorur për rastet e pagesave që shkojnë për Fond Kompensimi. Gjithashtu, janë ulur komisionet e ndërmjetësimit me të paktën 9%, nga 27.5% në 18.5% në nivel tregu për produktet e sigurimit të detyrueshëm motorik.

Ligjet e reja për sipërmarrjet e investimeve kolektive dhe për tregjet e kapitalit kanë përafuar legjislacionin tonë me Direktivat Evropiane, kanë modernizuar kuadrin ligjor për këto tregje, si edhe kanë krijuar mundësi të reja ndërlidhjeje me tregjet financiare ndërkombëtare. Gjithashtu ligjet e reja kanë vendosur standarde më të larta licencimi dhe mbikëqyrjeje, duke parashikuar edhe realizimin e një procesi strikt përputhshmërie të subjekteve që operojnë në këto tregje. Për më tepër, projektligji i ri i hartuar nga Autoriteti për fondet private të pensioneve realizon një përafrim të këtij ligji me Direktivën Evropiane, si edhe synon të zhvillojë tregun e pensioneve private, - theksoi në fjalën e tij Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF.

Ofrimi i shërbimeve që lidhen me sigurimin e detyrueshëm motorik në portalin e-Albania u veçua si një zhvillim i rëndësishëm për vitin 2021 nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së. Në këtë mënyrë, rreth 680 mijë qytetarë të cilët pajisen çdo vit me një policë së sigurimit të detyrueshëm motorik, (tpl apo karton jeshil) mund të aksesojnë informacionet apo vërtetimet e nevojshme në lidhje me vlefshmërinë e policës së tyre aktuale të sigurimit, historikun e sigurimit të mjeteve, historikun e dëmeve, si dhe të njoftohen në kohë përpara afatit të skadimit të siguracionit të tyre, në mënyrë që ta rinovojnë atë, - theksoi z. Mete.

Në fund të fjalës së tij, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së përmendi disa nga drejtimet kryesore të veprimtarisë së Autoritetit përgjatë këtij viti dhe në vazhdim, me fokus hartimin dhe miratimin e të gjithë bazës rregullatore në zbatim të ligjeve të reja, përparimin drejt standardeve më të mira ndërkombëtare në mbikëqyrje, zhvillimin dhe zgjerimin e mëtejshëm të tregjeve financiare, etj.

Disa nga drejtimet kryesore të veprimtarisë së Autoritetit përgjatë këtij viti dhe në vazhdim, do të fokusohen në hartimin dhe miratimin e të gjithë bazës rregullatore në zbatim të ligjeve të reja, përparimin drejt standardeve më të mira ndërkombëtare në mbikëqyrje, zhvillimin dhe zgjerimin e mëtejshëm të tregjeve financiare, etj.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Ecuria e tregut të sigurimeve në Shqipëri, Janar – Prill 2022

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-prill 2022 kapën vlerën 5,841 milionë lekë, ose 9.09% më shumë se në janar-prill 2021. Gjatë periudhës janar-prill 2022, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 336,139 me një rritje prej 24.85% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.


Tregu mbetet i orientuar te sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.12% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 7.83%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 42.93% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 57.07% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-prill 2022, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 2,173 milionë lekë, ose 14.54% më pak se në periudhën janar-prill 2021.

Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për periudhën janar-prill 2022 kapën vlerën 1,396 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 1.03% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Struktura e tregut të sigurimeve, Janar – Prill 2022 (Në %)

Tregu mbetet i orientuar te sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.12% të vëllimit të përgjithshëm të primeve.



ZHVILLIME TË TJERA

Zhvillohet konferenca ndërkombëtare “Diversifikimi i sistemit financiar përmes reformave të tregut të kapitaleve”



Tiranë, 19 maj 2022 – Konferenca ndërkombëtare
“Diversifikimi i sistemit financiar përmes reformave të tregut të kapitaleve”

Konferenca shërben si një platformë dialogu mes aktorëve kryesorë në vend, si dhe institucioneve financiare ndërkombëtare, për të intensifikuar përpjekjet e përbashkëta drejt shndërrimit të tregjeve të kapitalit në një alternativë të qëndrueshme financimi përkundrejt burimeve tradicionale.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në bashkëpunim me Bankën Botërore (BB) dhe Sekretariatit Shtetëror të Zvicrës për Çështjet Ekonomike (SECO), organizoi më 19 maj 2022 konferencën ndërkombëtare me temë “Diversifikimi i sistemit financiar përmes reformave të tregut të kapitaleve”.

Konferenca ishte e organizuar në tre panele kryesore, ku Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF, z. Ervin Mete, ishte pjesë e panelit të parë me temë “Zhvillimi i sektorit financiar në Shqipëri: nga forcimi i stabilitetit financiar në mbështetjen e rritjes ekonomike”, të drejtuar nga z. Michael Edwards, Këshilltar i lartë për sektorin financiar pranë Bankës Botërore, me panelistë znj. Delina Ibrahimaj, Ministre e Financave dhe Ekonomisë dhe z. Gent Sejko, Guvernator i Bankës së Shqipërisë. Panelistët diskutuan mbi rolin e institucioneve financiare në forcimin e stabilitetit, diversifikimin e tregjeve financiare, si edhe mundësitë e shfrytëzimit të potencialeve të tregjeve të kapitalit në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit.



Tema e panelit të dytë të konferencës ishte “Diversifikimi dhe zhvillimi i tregjeve të kapitalit – këndvështrimi i Institucioneve Financiare Ndërkombëtare”. Në panelin e drejtuar nga z. Max Weber, Partner i Ernst & Young Gjermani, morën pjesë z. Emanuel Salinas Munoz, Menaxher i Bankës Botërore për Shqipërinë, znj. Yan Sun, Drejtuese e Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar për Shqipërinë, si edhe z. Jim Turnbull, Nëndrejtor i Zhvillimit të Tregut të Kapitaleve nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) Londër. Panelistët ofruan pikëpamjet e institucioneve financiare ndërkombëtare mbi rëndësinë e diversifikimit të tregjeve financiare, nisur edhe nga efektet e pandemisë dhe krizës së fundit, konstatimet e tyre mbi situatën aktuale ekonomike, si edhe perspektivat për të ardhmen.



Paneli i tretë titullohej “Eksperiencat rajonale, harmonizimi dhe përafrimi me legjislacionin e BE-së për tregun e kapitaleve” dhe u drejtua nga znj. Mimoza Kaçi, Nëndrejtoreshë Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Në këtë panel morën pjesë znj. Birgit Puck, Drejtore e Mbikëqyrjes së Tregut të Titujve në Autoritetin Austriak të Tregjeve Financiare, z. Žiga Kosi, Këshilltar i Lartë në Agjencinë Sllovene të Tregut të Titujve, z. Paul Baranga, Drejtor i Mbikëqyrjes së Integruar në Autoritetin Rumun të Mbikëqyrjes Financiare, z. Andi Ballta, Drejtor i Përgjithshëm i Bankës Amerikane të Investimeve, Bashkëaksioner i ALSE, si edhe z. Ivan Shteriev, Drejtor Ekzekutiv i Bursës Maqedonase. Panelistët ofruan pikëpamjet e tyre në lidhje me sfidat e përafrimit të legjislacionit dhe direktivave evropiane për tregjet e kapitalit, si edhe praktikatat më të mira që vendet e rajonit kanë ndjekur për zhvillimin e këtyre tregjeve.

Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të AMF-së, Z. Ervin Mete në konferencën ndërkombëtare “Diversifikimi i sistemit financiar përmes reformave të tregut të kapitaleve”



I nderuar Zv/Kryeministër,
E nderuar Ministre e Financave,
I nderuar Guvernator,
Të nderuar përfaqësues të institucioneve financiare ndërkombëtare,
Të nderuar pjesëmarrës,

Kam kënaqësinë t'ju uroj mirëseardhjen si dhe t'ju falenderoj për praninë në këtë konferencë, e para e këtij formati dhe e këtyre përmasave për tregjet e kapitalit në Shqipëri, e cila synon të promovojë rëndësinë e zhvillimit të këtyre tregjeve si burim potencial ende i pashfrytëzuar drejt një rritjeje ekonomike të qëndrueshme.

Konferenca shërben si një platformë dialogu mes aktorëve kryesorë në vend, si dhe institucioneve financiare ndërkombëtare, për të intensifikuar përpjekjet e përbashkëta drejt shndërrimit të tregjeve të kapitalit në një alternativë të qëndrueshme financimi përkundrejt burimeve tradicionale.

Vlerë e shtuar do të jenë pikëpamjet e rregullatorëve dhe aktorëve të tregut nga vendet e BE-së dhe të rajonit, të cilët do të ndajnë me ne eksperiencat e tyre në këtë drejtim.

Eventi organizohet së bashku me Bankën Botërore dhe Sekretariatën Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO), të cilët gjej rastin t'i falenderoj posaçërisht për mbështetjen e vazhdueshme dhe të pakursyer për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, në drejtim të konsolidimit institucional dhe përafrimit ligjor e rregullator me standardet më të mira ndërkombëtare.

Mesazhi është i thjeshtë: “Le të shfrytëzojmë potencialin e tregjeve të kapitalit, dhe t'i vëmë ato në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit”.

vijon ...

Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të AMF-së, Z. Ervin Mete në konferencën ndërkombëtare “Diversifikimi i sistemit financiar përmes reformave të tregut të kapitaleve”

... vijon

Zhvillimet aktuale gjeopolitike, por edhe situata pandemike e viteve të fundit kanë shtuar edhe më tej nevojën për likuiditet dhe akses në kapital, duke e bërë edhe më të rëndësishëm ekzistencën e një tregu të zhvilluar kapitalesh, mirë-funksionues, eficient dhe të mirë-rregulluar.

Funksionimi i duhur i tregjeve të kapitalit është kyç në forcimin e ekonomisë dhe ruajtjen e stabilitetit financiar. Një treg i zhvilluar ofron më shumë mundësi investimi si dhe alternativa të reja financimi. Përmes kanalizimit të kursimeve drejt sektorëve produktivë dhe novativë këto tregje nxisin zhvillimin e biznesit dhe rrjedhimisht shoqërohen me përfitime që shtrihen në të gjithë ekonominë.

Një treg i zhvilluar kapitalesh si segment i sistemit financiar ndihmon në diversifikimin e burimeve të financimit, por edhe në zbutjen e ekspozimit të tij ndaj riskut sistematik, duke qenë se risku nuk përqendrohet më i tëri tek sistemi bankar.

Në këtë kuptim, zhvillimi i këtij tregu, krahas sistemit bankar, është një vlerë e shtuar për transformimin dhe qëndrueshmërinë e ekosistemit financiar shqiptar, prandaj tregjet e kapitalit duhen konsideruar si plotësues të sistemit bankar dhe jo zëvendësues të tij, duke qenë se së bashku ata përbëjnë një model optimal të financimit të ekonomisë.

Për këtë arsye, vlerësohet se një sistem bankar solid së bashku me tregje të diversifikuara të kapitalit janë rrugët kryesore të frymëmarrjes për ekzistencën e një sistemi të shëndetshëm financiar.

Me lëvizjen e lirë të kapitalit dhe ndërveprimin me tregjet e huaja, tregu shqiptar i kapitaleve mund dhe duhet të bëhet tërheqës edhe për investime në tituj nga investitorë jashtë vendit, përfshirë këtu edhe thithjen e investimeve nga diaspora shqiptare.

Por megjithë rëndësinë që ka ky treg, ai karakterizohet ende nga një prezencë e ulët në sistemin financiar shqiptar.

Ekosistemi i tregut të kapitaleve ka ende shumë hapësirë për emetues të rinj në anën e ofertës, përtej emetimit të bonove apo obligacioneve shtetërore nga ana e Qeverisë, apo emetimit të obligacioneve me ofertë private. Në këtë drejtim një listim i mundshëm i disa kompanive me kapital shtetëror apo emetimi prej tyre i obligacioneve me ofertë publike do të ishte një shembull i mirë për emetuesit e tjerë korporativë.

Gjithashtu, në anën e kërkesës, zhvillimi i mëtejshëm i investitorëve institucionalë, si fondet e investimit, fondet e pensioneve apo kompanitë e sigurimit do t'i jepte më shumë hov zhvillimit të tregut.

vijon ...

Ligjet e reja për tregjet e kapitalit dhe sipërmarrjet e investimeve kolektive, të cilat harmonizojnë legjislacionin tonë me atë të Bashkimit Evropian, kanë përmirësuar ndjeshëm kuadrin e nevojshëm ligjor, standardet e mbikëqyrjes dhe kërkesat për transparencë e mirëqeverisje

**Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të AMF-së,
Z. Ervin Mete në konferencën ndërkombëtare
“Diversifikimi i sistemit financiar përmes reformave të
tregut të kapitaleve”**

... vijon

Ligjet e reja për tregjet e kapitalit dhe sipërmarrjet e investimeve kolektive, të cilat harmonizojnë legjislacionin tonë me atë të Bashkimit Evropian, kanë përmirësuar ndjeshëm kuadrin e nevojshëm ligjor, standardet e mbikëqyrjes dhe kërkesat për transparencë e mirëqeverisje, të cilat synojnë rritjen e besimit në mekanizmat e tregut, si element thelbësor të nxitjes së pjesëmarrjes së investitorëve në këtë treg.

Në linjë me rregullimet evropiane, aktet e reja ligjore kanë sjellë shumëllojshmëri në ofrimin e shërbimeve të investimit, mundësi të zgjeruar ndërlidhjeje me tregjet globale, si edhe ofrimin e një game të gjerë të instrumenteve financiare.

Së bashku me plotësimin tërësor të infrastrukturës së tregtimit dhe pastregtimit, ligjet e reja kanë krijuar kuadrin e nevojshëm për zhvillimin e këtij tregu dhe shfrytëzimin e alternativave të reja të investimit.

Në këtë pikë, çështja që shtrohet është sesi të arrijmë më shpejt dhe më cilësisht këtë zhvillim të dëshiruar të tregjeve të kapitalit në Shqipëri dhe kjo do të jetë ajo që folësit e spikatur të kësaj konference do të diskutojnë në panelet vijuese.

AMF nxjerr për konsultim publik projektregulloren në zbatim të ligjit “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”



AMF ▾ Legjislacioni ▾ Stabiliteti Financiar ▾ Mbrojtja e Konsumatorit ▾ Edukimi Financiar ▾ Regjistri i të Licencuarve ▾ Programi i Transparencës ▾ Publikime ▾

Projektakte

Faqe Kryesore ▸ Legjislacioni ▸ Projektakte ▸

Projektregullore "Për njohjen e SIK me ofertë publike të licencuar në një vend anëtar të BE-së dhe Shoqërisë Administruese apo degës së Shoqërisë Administruese të SIK të licencuar në një vend anëtar të BE-së për shitjen dhe marketimin e SIK me ofertë publike në Republikën e Shqipërisë"

Projektregullore "Për njohjen e SIK me ofertë publike të licencuar në një vend anëtar të BE-së dhe Shoqërisë Administruese apo degës së Shoqërisë Administruese të SIK të licencuar në një vend anëtar të BE-së për shitjen dhe marketimin e SIK me ofertë publike në Republikën e Shqipërisë"

VERIFIKONI POLICËN TUAJ ▸

DEPOZITO ANKESËN ONLINE

Materiali i plotë

AUTORITETI I MBIKËQYRJES
FINANCIARE

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të Ligjit nr. 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, ka hartuar projektregulloren “Për njohjen e sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike të licencuar në një vend anëtar të BE-së dhe shoqërisë administruese apo degës së shoqërisë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive të licencuar në një vend anëtar të BE-së për shitjen dhe marketimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike në Republikën e Shqipërisë”.

Projektregullorja publikohet në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik në linkun: <https://amf.gov.al/projekt.asp?id=82>


Projektrregullorja publikohet në faqen zyrtare të Autoritetit <https://amf.gov.al/projekt.asp?id=82>

Diversiteti dhe gjithëpërfshirja – Përfaqimi i ngjyrave të vërteta në mbikëqyrjen financiare


Jeffery Yong
Këshilltar
Instituti i Stabilitetit Financiar



Search the website



[Home](#) / [About](#) / [Financial Stability Institute](#) / [Publications](#)



Diversity and inclusion - embracing the true colours in financial supervision

FSI Insights | No 42 | 24 May 2022
by [Jeffery Yong](#) and [Nompumelelo Simelane](#)
[PDF full text \(623kb\)](#) | 29 pages

[Executive Summary](#)

Sound diversity and inclusion (D&I) practices by financial institutions can support the core prudential objective of promoting safety and soundness of the financial sector. D&I can improve the quality of corporate governance of regulated financial institutions and promote fair and equitable treatment of customers, thus contributing to the mitigation of reputational and legal risks.



https://www.bis.org/fsi/publ/in_sights42.htm

Praktikat e mira të diversitetit dhe gjithëpërfshirjes (D&I) nga institucionet financiare mund të mbështesin objektivin thelbësor të tyre, kujdesit për të promovuar sigurinë dhe qëndrueshmërinë e sektorit financiar. D&I mund të përmirësojë cilësinë e qeverisjes korporative të institucioneve të rregulluara financiare dhe të promovojë trajtim të drejtë dhe të barabartë të klientëve, duke kontribuar kështu në zbutjen e rreziqeve të reputacionit dhe ligjor.

Ky material studimor shqyrton qasjet e reja rregullatore mbi praktikat e D&I të institucioneve financiare. Ai nxjerr në pah se ka pasur përparim të dukshëm në përmirësimin e praktikave të D&I, si brenda organizatave të tyre ashtu edhe jashtë në marrëdhëniet me klientët. Qasjet rregullatore për D&I mbulojnë kërkesat ose udhëzimet mbi diversitetin e vendimmarrësve brenda firmave në mënyrë që të promovojnë strategji të shëndosha biznesi si dhe politika më të gjera të drejtësisë sociale, të cilat synojnë përfshirjen e grupeve të nënpërfaqësuar të popullsisë në fuqinë punëtore dhe si konsumatorë financiarë.

Qasjet rregullatore të D&I për qeverisjen e korporatave, sjelljen e biznesit dhe shpërfaqjen e informacionit, ndryshojnë sipas juridiksioneve. Shumica e progresit të deritanishëm është fokusuar në diversitetin gjinor. Në këtë sfond, standardet dhe udhëzimet ndërkombëtare për D&I mund të jenë të dobishme për të përshpejtuar ritmin e progresit, për të zgjeruar fushëveprimin përtej diversitetit gjinor dhe në përgjithësi, për të rritur sigurinë dhe qëndrueshmërinë e firmave dhe sektorit financiar.

Global Risk Regulator

Kërcënime të reja për stabilitetin financiar po shfaqen me shpejtësi (*New threats to financial stability rapidly emerging*)

Justin Pugsley

<https://www.globalriskregulator.com/Subjects/Capital/New-threats-to-financial-stability-rapidly-emerging>

Pandemia e Covid-19 mezi po shuhet gradualisht dhe organizmat globale, tashmë të njohura po japin paralajmërime për rreziqe të reja për stabilitetin financiar. Këtë herë në lidhje me rritjen e inflacionit, rritjen e normave të interesit, dobësitë e tregjeve në zhvillim dhe luftën në Ukrainë.

Cili është hapi tjetër për rregullimin e kriptove?

(*What's next for crypto regulation?*)

Charley Cooper

<https://www.globalriskregulator.com/Subjects/Financial-Markets/What-s-next-for-crypto-regulation>

Madhësia dhe shtrirja e industrisë së kriptove po rritet me shpejtësi, gjë që ka rënë në sy të rregullatorëve. Sot, kapitali global i tregut të industrisë së kriptove është 2.1 trilion dollarë, ndërsa një sondazh i fundit i NBC zbuloi se një në pesë të rritur në SHBA ka investuar, tregtuar ose përdorur kriptovaluta.

FSB: A janë kriptot një kërcënim për stabilitetin financiar global?

(*FSB: is crypto a threat to global financial stability?*)

Kate Gee and Elliott Fellowes

<https://www.globalriskregulator.com/Subjects/Financial-Markets/FSB-is-crypto-a-threat-to-global-financial-stability>

Në identifikimin e problemeve të mundshme në një nivel makro-sistemik, raporti është edhe i ashpër dhe i qartë: "Tregjet e aktiveve kripto po evoluojnë me shpejtësi dhe mund të arrijnë një pikë ku ato të përfaqësojnë një kërcënim për stabilitetin financiar global për shkak të shkallës së tyre, dobësive strukturore dhe rritjes së ndërlidhjes me sistemin tradicional financiar."

Bordi i Stabilitetit Financiar (FSB) u bën rekomandime vendeve të G20-s mbi rregullat financiare. Raporti i tij shërben si një shenjë e qartë se rregullatorët ndërkombëtarë duhet të veprojnë tani për të zbutur rreziqet e mundshme për tregjet financiare globale të paraqitura nga kripto asetet. Kjo ndjenjë e urgjencës përshkon raportin. Raporti i FSB titullohet "Vlerësimi i rreziqeve ndaj stabilitetit financiar nga asetet kripto", shqyrton zhvillimet dhe dobësitë shoqëruese në lidhje me seksione të ndryshme të tregjeve të aseteve të kriptove, duke përfshirë asetet kripto të pambështetura (të tilla si bitcoin), monedhat e qëndrueshme (stablecoins), financat e decentralizuara (defi) dhe platformat e tregimit të kriptove aseteve.

BOSNJE-HERCEGOVINË

www.xprimm.com

Sipas raportimit të SeeNews, që i referohet të dhënave zyrtare të publikuara, biznesi i kompanive të sigurimit që operojnë në Federatën e Bosnje-Hercegovinës për periudhën janar – prill 2022 u zgjerua me 9% (e shprehur në terma vjetore) duke arritur në 196.5 milionë BAM ose rreth 100.5 milionë euro.

Sipas shifrave të publikuara në faqen zyrtare *online* të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Federatës së Bosnje-Hercegovinës, gjatë periudhës janar – prill 2022, vëllimi i primeve të shkruara bruto në sektorin e sigurimit të Jo-Jetës u rrit me 6.7% duke arritur në 151.1 milionë BAM, ndërsa në sektorin e sigurimit të Jetës u rrit me 17.2% duke arritur në 45.4 milionë BAM. Në fund të prillit, në Federatën e Bosnjës, operonin 20 kompani sigurimesh.

GREQI

www.xprimm.com

Sipas statistikave paraprake për tremujorin e parë të vitit 2022, të publikuara nga HAIC – Shoqata Helenike e Shoqërive të Sigurimeve, në fund të muajit mars, tregu i sigurimeve në Greqi ishte 1.06 miliardë euro, ose 1.3% më pak në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Segmenti i sigurimeve të Jetës ra me 9.7% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke arritur në 468.4 milionë euro, ndërsa nënklasat e sigurimit të përgjithshëm (sigurime të Jo-Jetës) u zgjeruan me 6.5%, duke arritur në 597.5 milionë euro.

Rezultatet e publikuara nga HAIC për tregun në tremujorit e parë 2022, përfshijnë shifrat për 52 shoqëri sigurimesh, nga të cilat 17 ishin shoqëri aktive në sigurimet e Jetës dhe 45 ishin shoqëri aktive në sigurimet e Jo -Jetës.

KOSOVË

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës, BQK, tregu i sigurimeve në Kosovë arriti në 29.8 milionë euro në fund të tremujorit të parë 2022, dukë shënuar një rritje prej 16.1% (e shprehur në terma vjetorë).

Sipas publikimit mujor në faqen e BQK-së “Sistemi Financiar”, vëllimi i primeve të shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rrit, duke arritur në 1.9 milionë euro. Sigurimet e Jo-Jetës u rritën me 13%, duke arritur në 27.9 milionë euro. Primet e shkruara bruto për sigurimin MTPL e brendshme arritën në 14.6 milionë euro; për policat kufitare arritën në 1 milionë euro.

Shifrat tregojnë se rezultati tremujor agregat i tregut ishte pozitiv dhe 12 siguresit vendas raportuan një fitim neto prej 0.4 milionë euro, nga një humbje neto prej -0.6 milionë euro në fund të marsit 2021. Në të njëjtën kohë, totali i aktiveve të mbajtura nga kompanitë kosovare të sigurimeve u rrit në 249 milionë euro në fund të tremujorit të parë të vitit 2022, nga 224.5 milionë euro që ishte në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

MALI I ZI

www.xprimm.com

Sifç tregonjë shifrat paraprake zyrtare, vëllimi i primeve të shkruara bruto për të siguruesit e Malit të Zi u rrit me 12.80% në tremujorin e parë të 2022, duke arritur në 26.89 milionë euro.

Sipas shifrave paraprake të publikuara nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Malit të Zi (ISA), vëllimi i primeve të shkruara bruto në sigurimet e Jo-Jetës për periudhën janar-mars 2022 arriti në 22.50 milionë euro duke shënuar një rritje me 13.88% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Ndërsa në sigurimet e Jetës vëllimi i primeve të shkruara bruto u rrit, duke arritur në 4.39 milionë euro.

Statistikat e periudhës janar – mars 2022 tregojnë se totali i dëmeve bruto të paguara u rrit me 3.80% dhe arriti në 10.52 milionë euro, nga të cilat 2.46 milionë euro, ishin dëme të paguara në sigurimin e Jetës dhe pjesa e mbetur prej 8.06 milionë euro ishin pagesa të dëmeve për kontrata të sigurimit të Jo-Jetës.

Statistikat e publikuara nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Malit të Zi përfshijnë të dhëna për nëntë shoqëri sigurimesh që operojnë në vend, nga të cilët katër janë shoqëri Sigurimi të Jetës.

MAQEDONIA E VERIUT

www.xprimm.com

Gjatë tre muajve të parë të vitit 2022, Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve e Maqedonisë së Veriut, ISA, ka shqyrtuar 52 ankesa të ardhura ndaj kompanive të sigurimit, nga personat e siguruar. Kjo shifër është tre herë më e madhe se ajo e të njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Pjesa më e madhe e tyre janë ankesa lidhur me dëmet e ndodhura të automjeteve, të cilat janë rritur gati 4 herë.

Më shpesh, të siguruarit ankohen për shërbimin e Raportit Evropian të sigurimeve gjatë zgjidhjes së dëmeve në trafik. Nga numri tërësor i ankesave, 27 që kanë të bëjnë me përgjegjësinë ndaj palëve të treta (klasa më e madhe e sigurimit të detyrueshëm të automjeteve), 19 ankesa janë për shkak të veprimeve të kompanive të sigurimit sipas Raportit Evropian të sigurimeve të dëmeve. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, në tremujorin e parë të vitit 2022, 4 herë më shumë të siguruar janë ankuar për këtë shërbim.

Rritje të ndjeshme kanë pësuar edhe ankesat ndaj pagesave të dëmeve në sigurimin e pronës, e cila është klasa më e madhe e sigurimit vullnetar. Ekspertët e ISA kanë marrë 13 ankesa nga persona të siguruar, dy herë më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit 2021.

TURQI

www.xprimm.com

Sipas shifrave paraprake të publikuara nga Shoqata e Sigurimeve të Turqisë (TSB), vëllimi i primeve të shkruara bruto të gjeneruara në tregun turk të sigurimeve, gjatë periudhës janar-mars 2022, u rrit me 70.41% e shprehur në monedhën vendase duke arritur në 43.10 miliardë TRY. Ndërsa e shprehur në monedhën evropiane, për shkak të zhvlerësimit të lirës turke ndaj euros, tregu lokal i sigurimeve u rrit vetëm me 2.22% duke arritur në 2.64 miliardë euro. Në 31 mars 2021 këmbimi ishte 1euro = 9,7688 lira turke TRY, ndërsa më 31 mars 2022 1 uro = 16,2855 lira turke, TRY.

Duke analizuar shifrat e tregut turk të sigurimeve, të shprehur në monedhën vendase, primet e shkruara bruto të sigurimeve të Jo-Jetës në tremujorin e parë të 2022 u rritën me 74.17% duke arritur në 37.30 miliardë TRY. Primet e sigurimit të Jetës u rritën me 49.65% në vit dhe arritën në 5.79 miliardë TRY.

Shoqata e Sigurimeve të Turqisë numëron 60 anëtarë aktivë në tregun e sigurimeve të Jetës dhe Jo-Jetës.



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al